



Datë: 26.03.2026

Numër protokolli: 1601/2026

A.nr.967/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, pas kërkesës së datës 21.11.2025, për riaktivizimin e lëndës, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.967/2024, të datës 03.07.2024, të parashtruar nga ankuesi Z.H., të cilin me autorizim e përfaqëson Valentina Kaçandolli Bekteshi nga Prishtina, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1, nenin 16, paragrafi 3, si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 26.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Anullohet Vendimi A.nr.967/2024, i datës 02.09.2024, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.967/2024, e datës 03.07.2024, e parashtruar nga ankuesi Z.H.

III. Anullohet Vendimi Nr.469/VI/2024, i datës 18.06.2024, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që në afat prej 15 ditës nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm administrativ në mënyrë që ankuesit ti bëhet kompensimi retroaktiv i diferencës së pagës së ekspertit (B3) nga muaji shkurt deri në muajin tetor 2023.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Z.H. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të aktit të emërimit të datës 01.12.2017, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik të SISH, ndërsa sipas Vendimit me Nr.198/V/2022 të datës 23.05.2022, është caktuar zëvendësues i pozitës Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatitur raportin lidhur me njohjen e sistemeve shtetërore me rendësi strategjike dhe ekspertëve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku për Ministrinë e Shëndetësisë sipas këtij raporti si sisteme janë pranuar: *Sistemi Informativ Shëndetësor (BHIS+Moduli i Vaksinimit, Moduli EPPV, Moduli i Vizitave në Shtëpi)*, ndërsa në kuadër të pozitave të ekspertëve janë propozuar *Udhëheqës i Divizionit Planifikimit Strategjik të SISH, Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Shtetëror, Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave Zhvillues dhe Administrator i lartë të i sistemeve soufтверike dhe Administrator i TI-së për Sisteme*, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës, më datë 12.10.2023, përmes Vendimit Nr. 23/165, ka aprovuar listën e ekspertëve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Ankuesi, më datë 14.02.2024, ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Shëndetësisë, përmes të cilës ka kërkuar kompensimin retroaktiv të pagës si ekspert nga muaji shkurt deri në muajin tetor 2023, mirëpo nuk ka marr përgjigje në këtë kërkesë, duke parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ky i fundit më Vendimin A.nr.258/2024, ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, të shqyrtoj kërkesën e datës 14.02.2024, të ankuesit. Sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, më datë 18.6.2024, ka nxjerr Vendim me Nr.469/VI/2024, me të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 14.02.2024 ankuesit.

Ankuesi më datë 03.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimi me Nr.469/VI/2024, të datës 18.06.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas Vendimit A.nr.967/2024, të datës 02.09.2024, ka bërë pezullimin e procedurës administrative të iniciuar sipas ankesës së ankuesit me arsyetimin se ankuesi ka parashtruar ankesë të re në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për shkak të shqiptimit të masës disiplinore largim nga shërbimi civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 13.11.2025 ka nxjerr Vendim A.nr.1229/2025, duke aprovuar ankesën e ankuesit, duke anuluar Vendimin me numër protokollit 05-4727 të datës 19.06.2025, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe duke e kthyer ankuesin në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe duke njohur të drejtën e kompensimit të pagave nga koha e largimit deri në zbatimin e vendimit.

Ankuesi përmes përfaqësueses së tij, më datë 21.11.2025, ka parashtruar kërkesë për riaktivizim të lëndës A.nr.967/2024, duke kërkuar që kanë pushuar rrethanat që rasti tutje mos të mbetet e pezulluar, duke kërkuar që të njihet e drejta e kompensimit retroaktiv si ekspert nga muaji shkurt deri në muajin tetor 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3461/2024 të datës 03.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.469/VI/2024, të datës 18.06.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë; Autorizimin e datës 31.01.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 18.07.2024; Ndryshimin dhe Plotësimin e aktit të emërimit i datës 01.12.2017; Kartelën e nëpunësit shkurt-tetor 2023; Kërkesën e datës 14.02.2024 të ankuesit; Vendimin e datës 23.0.2022; Vendimin me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raportin e punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Vendimin A.nr.258/2024, A.nr.967/2024, A.nr.1229/2025 të KPMSHCK-së; Kërkesën për riaktivizimin e lëndës datës 21.11.2025 e parashtruar nga ankuesi;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me Nr.469/VI/2024, të datës 18.06.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, pretendon se marr parasysh Vendimin Nr. 23/165 të datës 12.10.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin pozita e tij është përfshirë në kuadër të pozitave të ekspertëve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke kërkuar kompensimin retroaktiv nga muaji shkurt deri në muajin tetor 2023.

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, paragrafi 1: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenit 14, paragrafi 3: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nisur nga objekti i ankesës thekson faktin se më hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria e Kosovës më datë 05.02.2025 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, në fuqi nga data 06.02.2023 deri me 26.08.2024, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, Qeveria e Kosovës duke u bazuar në nenin 6 të kësaj rregullore më Vendimin Nr.07/132, të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike (tutje SHHIKS) i cili komision ka nxjerrë lidhur me njohjen e SSHIKS dhe listën e eksperteve të miratuara sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës e sipas të cilit *Sistemi Informativ Shëndetësi (BHIS+Moduli i Vaksinimit, Moduli i EPPV, moduli i Vizitave në Shtëpi)*, është përfshirë si sistem shtetëror me rëndësi strategjik, ndërsa edhe pozita e ankuesit si Udhëheqës i Divizionit të Planifikimit Strategjik të SISH është përfshirë sipas klasës B3.

Përkitazi me pretendimet ankimore të ankuesit që të paguhet në mënyrë retroaktive nga muaji shkurt deri në muajin tetor 2023, si ekspert, Kolegji i Këshillit, konstaton se pas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi ka realizuar pagës sipas koeficientit të përcaktuar si ekspert, mirëpo sa i përket çështjes retroaktive, Kolegji i Këshillit thekson se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, më datë 31.03.2023, ka përcjell opinion të të gjitha institucionet publike lidhur me efektet e ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me c 'rast sipas pikës 4 të opinionit sqarohet se: Punonjës të cilëve vet shtojca përkatëse e Ligjit, u është përcaktuar klasifikimi i posaçëm, p.sh: *ekspertë sipas shtojcës së posaçme, specialistët, inspektorët, punonjësit në arsim, shëndetësi, art, kulture e trashëgimi kulturore apo një fushë tjetër ?(vijon korrigjimi edhe në ditët dhe javët në vazhdim- pagat u barazohen retroaktivisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit)*. Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lartë dhe meqenëse pozita e ankuesit nga organi përgjegjës dhe kompetente është përfshirë në listën e eksperteve lidhur me Sistemet Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit, e drejta e kompensimit për pozita e njohura të eksperteve sipas Rregullores (QRK)Nr.11/2023 për Ekspertët, aplikohet në mënyrë retroaktive, pra për ankuesin nga muaji shkurt deri në muajin tetor 2023. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, vlerëson se Vendimi me Nr.469/VI/2024, i datës 18.06.2024, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, është nxjerr në kundërshtim me gjendjen faktike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe i cili plotëson kushtet e paligjshmërisë së aktit administrativ të përcaktuara me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar si më sipër, duke marr për bazë faktin se ankuesi është kthyer në vendin e punës sipas Vendimit A.nr.1229/2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërimin Civil të Kosovës, dhe marr për bazë kërkesën e datës 21.11.2025 të palës për riaktivizim të lëndës, atëherë bazuar në nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është anuluar Vendimi A.nr.967/2024 i datës 02.09.2024, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për pezullimin e procedurës administrative, dhe për rrjedhojë tashmë janë plotësuar kushtet ligjore që procedura administrative të shqyrtohet sipas vendimit përfundimtar.

Andaj, theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovoj ankesën të plotësuar më datë 03.07.2024 si të bazuar, të anuloj Vendimin me Nr.469/VI/2024, të datës 18.06.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe të detyroj Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrinë e Shëndetësisë që të bëjnë kompensimin e diferencës së pagës për ankuesit nga muaji shkurt deri në zbatimin e Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.967/2024

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Valentina Kaçandolli Bekteshi;
- Ministrisë së Shëndetësisë: Sekretarit të Përgjithshëm dhe
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK -së.